

KPK konfirmon në detyrë prokuroren Afërdita Ndoi

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit konfirmoi me shumicë votash prokuroren e rrethit Tiranë, Afërdita Ndoi dhe njëkohësisht e referoi atë për inspektim në Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë.

Autor: [Edmond Hoxhaj](#) | BIRN | Tiranë



Prokurorja Afërdita Ndoi (qendër), pas shpalljes së vendimit të KPK | Foto : Edmond Hoxhaj

Prokurorja e prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Afërdita Ndoi u konfirmuan në detyrë të en jten në mëngjes.

Vendimi i Komisioni të Pavarur të Kualifikimit me shumicë votash u dha nga trupa e përbërë nga komisionerët Olsi Komici kryesues, Firdes Shuli relatores dhe Brunilda Bektoshi anëtare. Në cilësinë e vëzhguesit ndërkombëtar ishte e pranishme Maria Tuma.

Pavarësisht konfirmimit të subjektit, KPK e ka referuar prokuroren për inspektim në ILD për një çështje për veprën penale mjekim i pakujdesshëm të vitit 2013, e cila është diskutuar gjerësisht gjatë seancës dëgjimore të mbajtur të mërkurën.

Ndoi është diplomuar në shkollën e Magjistraturës në vitin 2003. Ajo është emëruar fillimisht në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe është transferuar në vitin 2009 në prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Subjekti është vlerësuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) për të tri kriteret e vetingut, përfshirë pasurinë, pastërtinë e figurës dhe profesionalizmin.



RRETH AUTORIT

Edmond Hoxhaj

Edmond Hoxhaj është gazetar i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri. Ai ka punuar më herët për gazetën “Shqip”. Ai ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës në degën Gjuhë-Letërsi. Hoxhaj ka punuar që nga viti 2001 në disa media të shkruara, ku ka mbuluar çështjet e aktualitetit dhe të drejtësisë.